



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-054

**PËR MBROJTJEN JURIDIKE DHE MBËSHTETJEN FINANCIARE TË
PERSONAVE TË AKUZUAR POTENCIAL NË PROCESET
GJYQËSORE PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke konfirmuar edhe një herë qëndrimin dhe besimin e paluhatsëm që Lufta e armatosur e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ka qenë luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës, luftë kundër forcave ushtarake, policore, paramilitare dhe administratës okupuese të Serbisë në Kosovë;

Duke njohur sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të mbështetur nga NATO, e udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, të cilët ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës;

Me qëllim që të mbrohet dhe zbardhet e vërteta për proceset e mundshme gjyqësore që do të zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara, pa ndonjë ndërhyrje dhe veprim të mundshëm i cili do të mundësonte ndërprerjen e këtij procesi dhe i cili do të mund të linte njollë të pazgjydhur në historinë e re të Republikës së Kosovës;

Duke ritheksuar zotimin e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë qytetarëve të saj;

Duke rikonfirmuar gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës në vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, i paraqitur edhe në Marrëveshjen Ndërkombëtare të ratifikuar në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (Ligji nr. 04/L-274);

**LIGJ PËR MBROJTJEN JURIDIKE DHE MBËSHTETJEN
FINANCIARE TË PERSONAVE TË AKUZUAR POTENCIAL NË
PROCESET GJYQËSORE PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore dhe procedurat e ndërlidhura, për krimet e pretenduara pranë Dhomave të Specializuara.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj çdo personi i cili akuzohet për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara duke përfshirë mbrojtjen juridike për personat e akuzuar dhe mbështetjen financiare të anëtareve të ngushtë të familjes së tyre për udhëtimet që ndërlidhen me procedurat gjyqësore, që mbahen jashtë Republikës së Kosovës.

**Neni 3
Mbrojtja juridike**

1. Të gjithë personat e akuzuar kanë të drejtën e kërkesës për asistencë në mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes dhe të angazhimit të mbrojtësit të pavarur, me përvojë dhe kompetencë, që paguhen nga Buxheti i Kosovës, i alokuara për qëllimet e këtij Ligji.
2. Mbrojtja juridike e personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, duke përfshirë edhe angazhimin e mbrojtësit, bëhet sipas akteve nënligjore që do të miratohen nga Ministria e Drejtësisë.

**Neni 4
Mbështetja financiare**

1. Mbështetja e nevojshme financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara përfshinë shpenzimet e ndërlidhura me udhëtimet e tyre kur procedurat gjyqësore zhvillohen jashtë Kosovës.

2. Mbështetja e nevojshme financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara bëhet sipas aktit nënligjor të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

Neni 5 **E drejta në kompensim**

1. Personat ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë pranë Dhomave të Specializuara, kanë të drejtë të kërkojnë kompensim në rast se ata shpallen të pafajshëm me vendim të plotfuqishëm.

2. Kompensimi i personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, të shpallur të pafajshëm bëhet sipas aktit nënligjor të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

Neni 6 **Buxheti**

Kuvendi i Republikës së Kosovës merr vendim për ndarjen e mjeteve të caktuara për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të përcaktuar me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore që nxirren nga Ministria e Drejtësisë për zbatim të këtij Ligji.

KAPITULLI II **DISPOZITAT KALIMTARE**

Neni 7 **Koordinimi i zbatimit**

Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Drejtësisë do të sigurojë zbatimin e këtij ligji, deri në përfundim të zhvillimit të procedurave gjyqësore ndaj personave të akuzuar potencial pranë Dhomave të Specializuara.

Neni 8 **Mbikëqyrja**

Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa, Mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji.

Neni 9 **Aktet nënligjore**

Ministria e Drejtësisë miraton akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, më së largu tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-054
3 gusht 2015

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kadri VESELI